



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Prill 2021

Nr. 268

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike, Dega Memaliaj për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi
- Kërkues:** Z. Esmerald Xhemali, Kryetar i Partisë Demokratike, Dega Memaliaj
- Ndaj:** Kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi
- Baza Ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2 dhe 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 60, 61, dhe vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I.Vlerësimi Paraprak

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën e email-it denoncime.kqz@gmail.com nga Partia Demokratike, dega Memaliaj, është raportuar denoncimi i administruar nga KQZ me nr 3179 prot., datë 3.4.2021, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi me pretendimin se, në qytetin e Memaliajt, në kundërshtim me nenin 79 pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i



Data: 21 Prill 2021
Nr. 268

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike, Dega Memaliaj për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi

Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe pika 2 e udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është afishuar posteri i kandidatit të Partisë Socialiste në fasadën e një pallati të banuar dhe nuk është respektuar distanca prej 5 metra, nga zyra zgjedhore e subjektit të PS.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e paragrafi 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga subjekti kallëzues Partia Demokratike, përbëjnë indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

II. Rrethanat e faktit

Në datën 23.03.2021 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka miratuar udhëzimin nr. 6 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Në datën 28.03.2021, në adresën e emaili-t denoncime.kqz@gmail.com nga Partia Demokratike, dega Memaliaj, është raportuar denoncimi i administruar nga KQZ me nr. 3179 prot., datë 3.4.2021, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi, për shkelje të këtij udhëzimi, duke vendosur në një pallat banimi, materiale propagandistike, në kundërshtim të plotë me çfarë ky udhëzim parashikon.

Administrata e KQZ-së, përmes personit të autorizuar prej saj, ka verifikuar kallëzimin e bërë nga Partia Demokratike, ku gjatë raportit të ndërmjetëm të monitorimit, për Qarkun Gjirokastrë, rezulton se materialet propagandistike të vendosura në fasadën e pallatit që ndodhet në sheshin “Minatori”, Memaliaj nga subjekti Partia Socialiste, tashmë janë hequr.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2 dhe 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, udhëzimit nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

V E N D O S:

- 1.Përfundimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi.
- 2.Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
- 3.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- 4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 21 Prill 2021
Nr. 268

Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Partisë Demokratike, Dega Memaliaj për shkelje të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndaj kandidatit për deputet z. Bledi Çuçi